

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PD kërkon ngritjen e Komisionit Hetimor/ Bardhi: KAYO ka shpenzuar 34 mln euro! Si i mori këto para R on Yeffet
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/17/pd-kerkon-ngritjen-e-komisionit-hetimor-bardhi-kayo-ka-shpenzuar-34-mln-euro-si-i-mori-keto-para-ron-yeffet/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 07:42:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 07:40:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e318eab99b9924eb55c28ed54e47813fd4e8af338cba91c5e3ff5f77a762a738
TEKSTI	099ca811ffbc6365c97652a471f6c2c3b1ab8271c738988faec87a55aff61e39
PAMJA	7b6393a305aefd484da88f8bb2f19f98e8a976c50f74b9864534bf5d13cbfb8e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	be2c0c2025c85911522821b0965db3f7080e55b1029df8eba2c806cae79a8a77
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	81c8c13b2047f7f67d44b50c2b734087e798480a3f28f7a7cb4e41f88dd32922
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/be2c0c2025c85911522821b0965db3f7080e55b1029df8eba2c806cae79a8a77>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

PD kërkon ngritjen e Komisionit Hetimor/ Bardhi: KAYO ka shpenzuar 34 mln euro! Si i mori këto para Ron Yeffet

09:40 : 17/09/2026 në AKTUALITET, POLITIKE



Në Konferencën e Kryetarëve, kreu i grupit parlamentar të PD, Gazment Bardhi ka shpalosur kërkesën për ngritjen e Komisionit Hetimor për kompaninë KAYO. Në fjalën e tij, në mbledhjen me dyer të mbyllura, Bardhi ka deklaruar se kjo kompani ka shpenzuar 34 milionë euro dhe sipas tij çdo shqiptar duhet ta dijë sesi i mori ato para, Ron Yeffet.

"Kompania KAYO ka shpenzuar 34 milionë euro. Çdo shqiptar do të duhet të dijë se si i mori ato para miku o Edi Ramës Ron Yefet", ka deklaruar Bardhi.

Sipas tij, ka mospërputhje edhe në deklaratat zyrtare lidhur me aktivitetin e KAYO-s. Bardhi tha se ministri i Mbrojtjes ka deklaruar se kompania ka prodhuar dhe shitur armë, ndërsa më pas zv.ministrja ka deklaruar të kundërtën.

"Çdo komision hetimor ka për qëllim mbledhjen e informacionit. Ndryshe, për çfarë do të duhej komisioni? Në kërkesë kemi dhënë të gjitha informacionet dhe indiciet. Është fakt që KAYO deri tani ka shpenzuar 34 milionë euro nga buxheti i shtetit pa prodhuar asgjë. Ne nuk dimë çfarë ka përfutur shteti? Çfarë aktiviteti ka? Na rezultojnë që i vetmi fitues i këtyre parave është Ron Yefet, mik i Kryeministrit. Kjo del hapur në audio-përgjime dhe këtë audio-përgjim e konfirmoi kompania ku është bërë regjistrimi. E vërteta është që individ i Ron Yefet sillet si ministër i Mbrojtjes dhe e thotë hapur që ka trafik të armëve. Del hapur që u janë shitur armë vendeve në konflikt. Ne kemi thirrur ministrin në interpelancë dhe tha që kompania ka prodhuar armë dhe i ka shitur. Më pas del zv.ministrja dhe thotë nuk është prodhuar. Pra, duhet mësuar e vërteta?!", deklaroi kreu i grupit parlamentar të PD.

Lexo edhe:

Mbyllet protesta e 109-të në Tiranë/ Protestuesit: Nesër në dyert e Kuvendit!

Protestuesit e ndaluar ende në qeli, qytetarët zhvendosen te Blloku i Sigurisë: Nuk jeni vetëm!

Bardhi tha se opozita ka kërkuar informacion nga Ministria e Mbrojtjes, por ky informacion nuk është vënë në dispozicion. Ai argumentoi se pikërisht për këtë arsye nevojitet një

TË GJITHA



PD kërkon ngritjen e Komisionit Hetimor/ Bardhi: KAYO ka shpenzuar 34 mln euro! Si i mori këto para Ron Yeffet

09:40 : 17/09/2026



Presidenti dekreton shkarkimin e ish-ministrit Lamallari, Ervin Demo emërohet ministër i Brendshëm

09:20 : 17/09/2026



Seancë plenare dhe protestë, policia rrethon Parlamentin dhe vendos gardh metalik

09:06 : 17/09/2026



Tre të rinj plagosen me thikë në Sarandë, njëri dërgohet në Tiranë. Dy të arrestuar/ EMRAT

08:58 : 17/09/2026



Operacion antidrogë në Korçë, në pranga 3 të rinj që po udhëtonin me makinë. Sekuestrohet 6 kg kanabis

08:43 : 17/09/2026



Këmbimi valutor 17 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja

08:34 : 17/09/2026



Censurë, IA dhe deepfake: Lufta online rreth 'Revolucionit të Flamingove'

08:23 : 17/09/2026

komision hetimor.

“Janë shpenzuar 34 milionë euro. Kështu na thatë edhe për inceneratorët, por doli që paratë digjeshin në shesh. Kemi qaq kohë që kërkojmë informacion në Ministrinë e Mbrojtjes. Nuk jepet informacion. Refuzon ministri dhe për këtë i jam drejtuar Kryetarit të Kuvendit. Çfarë duhet të bëjmë ne, të futemi në ministri dhe të marrim dokumentat? Për këtë arsye duhet komisioni hetimor, sepse ai i nënshtrohet Kodit Penal nëse nuk jepet informacion. Ne nuk kërkojmë asgjë tjetër, veç të mësojmë dhe të njohim kontratat e lidhura mes një kompanie shtetërore me kompaninë private. Si e gjeti KAYO individin Ron Yefet? Cila është CV-ja që ka ky njeri, veç faktit që është mik i Edi Ramës? Si përfiton ky njeri në vetëm 6 muaj 34 milionë euro? Ne jemi të hapur për objektin e hetimit. Na thoni çfarë doni të rregullojmë. Ngritja e komisionit hetimor nuk ka nevojë për lejen tuaj, këtë na e jep Kushtetuta. Ne mund vetëm të diskutojmë objektin e hetimit”, tha Bardhi.

Etiketa: Edi Rama gazmend bardhi Kayo Ron Yeffet

Lajme të lidhura



Mbyllet protesta e 109-të në Tiranë/ Protestuesit: Nesër në dyert e Kuvendit!

22:26 : 16/09/2026



Protestuesit e ndaluar ende në qeli, qytetarët zhvendosen te Blloku i Sigurisë: Nuk jeni vetëm!

22:02 : 16/09/2026



Pas fjalimeve, rinis marshimi në Tiranë: Rama, jepe dorëheqjen!

21:03 : 16/09/2026



"Mburrësh si 'trajner' i madh, por shokët i ke në qeli", protestuesit mesazhe të forta për Ramën

19:58 : 16/09/2026



109-të ditë revoltë/ Protestuesit drejt Kryeministrit, paralajmërojnë mosbindje civile

19:34 : 16/09/2026



Vendimi për liderët e UÇK-së, reagon politika/ Rama: Marre! Bardhi: Ditë e rëndë për kombin shqiptar

13:01 : 16/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

